



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01. Nr. 16-36731/14
Kaçanik, 12.12.2014

Në bazë të nenit, 5 lidhur më nenet ; 12.1, 12.2(c), 40.2(a, g) dhe 17 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 16 të Ligjit nr.03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 dhe 8. të Ligjit nr.03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 34.5. të Statutit të komunës si dhe nenit 15.1(f) të Rregullorës për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 12.12.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E RREGULLORE S
PËR PAGESËN E TARIFAVE, NGARKESAVE ADMINISTRATIVE, GJOBAVE DHE
SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE

I.

Me këtë Vendim, APROVOHET, Rregullorja, **01Nr.16-36731/14**, më tekstin e mëtejshëm (Rregullorja për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale).

II.

Në rregullore është përcaktuar lartësia e tarifave dhe ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale të cilat u ofrohen qytetarëve dhe subjekteve afariste – biznesit në territorin e komunës.

Rregullorja përcakton në veçanti secilën tarifë dhe ngarkesë, detyrat dhe obligimet e çdo drejtorie dhe shërbimi së bashku me lartësinë dhe mënyrën e pagesës.

III.

Rregullorja është hartuar nga Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Drejtoritë tjera Komunale, e ndarë në gjithsej 13 pjesë, e përmbledhur në 32 nene dhe është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

IV.

Kjo Rregullore pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të komunës së Kaçanikut.

V.

Më hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja **01- Nr. 05-4236/10** për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale e datës **27.07.2010**, dhe çdo akt aktet tjetër i miratuara nga Kuvendi i Komunës që e ka ndryshuar dhe plotësuar të njëjtën deri me miratimin e kësaj Rregulloreje.

VI.

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesën : Kryetari i Komunës dhe të gjitha drejtoritë komunale.

Rregullorja iu dërgohet: MAPL, Kryetarit të Komunës, Drejtorive Komunale dhe Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi